



# STRATEGJIA PËR INTEGRIMIN NDËRETNIK NË ARSIM DHE PJESEMARRJA E TË RINJVE NË KOMUNËN E TEARCËS

PËRGADITI:

UDHËHEQËSI I DEPARTAMENTIT PËR ARSIM  
MUAMET REXHEPI

MIRATOI:  
KËSHILLI I KOMUNËS SË TEARCËS  
29 QERSHOR 2021

QERSHOR, 2021

## Lista e shkurtesave

BZHA – Byroja për Zhvillimin e Arsimit

ISHA – Inspektorati Shtetëror i Arsimit

BE – Bashkimi Evropian

ICPSH – Indikatorët për Cilësinë e Punës së Shkollave

INA – Integrimi Ndëretnik në Arsim

MASH – Ministria e Arsimit dhe Shkencës

OJQ – Organizata Joqeveritare

KP – Këshilli i Prindërve

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut

QAPT – Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim

KSH – Këshilli Shkollor

## 1. HYRJE

Motori i ndryshimeve në shoqëri është rinia. Sa më shumë shoqëria investon sot në edukimin, arsimimin e të rrinjëve, aq më të sigurt e ka të ardhmen ajo shoqëri.

Çështja e zvogëlimit të paragjykimeve dhe stereotipeve, është një pengesë e theksuar në rrugëtimin e sigurt të të rrinjëve. Shoqëria ka obligim që të rrinjëve t'ju trasojë rrugë të sigurt, të ardhme të shëndoshë. Pasi komuna jonë është multietnike dhe multikonfesionale, këtë atribut duhet shfrytëzuar në maksimum në kuptim të rritjes së vlerave të përbashkëta dhe eliminimit të ndasive dhe ndryshimeve eventuale. Njohja me njëri tjetrin dhe për njëri tjetrit duhet të fillojë që në vegjëli, që nga hapat e parë në shkollë.

Shoqëria duhet të kalit të rrinjë pa paragjykime dhe të hapur ndaj njëri tjetrit. Shkollat në planprogramet e tyre të praktikojnë dhe promovojnë respektimin e kulturave, traditave dhe dokeve për njëri tjetrin. Ajo që është edhe obligim ligjor, që arsimtarët gjatë përgaditjes së tyre, të hartojnë dhe mbajnë orë me aktivitete nga INA.

Shkollat duhet të promovojnë karakterin multikulturor të shoqërisë që na rrethon. Kjo do të realizohet nëpërmjet të aktiviteteve të përbashkëta vetanake dhe me shkollat partnere nga INA.

Reformat në arsim nuk e përfshijnë vetëm përmirësimin e njohurive akademike por edhe mësimin i cili u ndihmon nxënësve të përgatiten të jetojnë në një shoqëri multikulturore dhe kjo është theksuar si në shumë dokumente ndërkombëtare (UNESKO, UNICEF, Këshilli i BE-së), ashtu edhe në dokumentet zyrtare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucionet arsimore: Ligjin për arsim fillor (me ndryshimet, i sjellë më 5 gusht 2019); Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçar dhe arsimin (MASH dhe BZHA, 2007); Indikatorë për cilësinë e punës së shkollave (MASH dhe ISHA, 2015); Kompetenca dhe standarde profesionale kryesore për mësimdhënësit, kompetenca për drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme.

-Kyçja e aktiviteteve nga INA në arsim paraqet sfidë, nxitje, motivim, imperativ i kohës për respekt të ndërsjellë në kuptim të elementeve kulturore, dokeve, zakoneve dhe traditës. Njohja me njëri tjetrin është garancë se po krijojmë një shoqëri pa paragjykime e cila nesër do jetë bartëse e kultivimit të një shoqërie të shëndoshë multietnike. Promovimi dhe praktimi i elementeve të multikulturazimit do rrit vlerat shoqërisë sonë multikulturore.

Komuna e Tearcës në bashkëpunim me shkollat është e përkushtuar të krijojë politikën e saj për promovimin e integritit ndëretnik në arsim dhe përfshirjen qytetare të të rinjve, planifikon aktivitete sipas karakteristikave të vetë shkollave. Në kuadër të aktiviteteve për integrimin ndëretnik në arsim do të promovohet interaksioni dhe socializimi midis nxënësve të bashkësive/gjuhëve të ndryshme mësimore edhe në shkollat njëgjuhëshe dhe më shumëgjuhëshe.

Kur nxënësit marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta, ata kanë mundësi për komunikim të drejtpërdrejtë dhe kontakt me njëri-tjetrin, të njoftohen me njëri-tjetrin dhe formimin e relatave interpersonalë, mësim për njëri-tjetrin prej të tjerëve dhe për uljen e stereotipave negative dhe paragjykimëve për të tjerët. Në aktivitetet për përfshirjen qytetare të të rinjve, ata do të orinetohen dhe mbështeten të identifikojnë probleme konkrete në shkollë dhe në bashkësi. Më pas, në bazë të vendimeve të përbashkëta, të rinjtë do të ndërmarrin nisma për veprime me qëllim që të kontribuohet drejt zgjidhjes së problemeve ekzistuese dhe mangësive në nivel të shkollës dhe të bashkësisë.

- Duke e pasur parasysh strukturën multietnike të popullatës në komunën e Tearcës, ndërsa njëherësh edhe në sistemin arsimor, komuna e Tearcës solli vendim në mënyrë konstante ta zhvillojë bashkëpunimin në fushën e integritit ndëretnik në arsim dhe përfshirjen qytetare të të rinjve në bashkësi.

Nxënësit në komunën e Tearcës të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta mësimore përmes orëve të përbashkëta dhe/apo projekteve hulumtuese, aktiviteteve të përbashkëta jashtëmësimore dhe të lira të nxënësve, siç janë ekskursione, seksione, shfaqje teatrale, punëtori kreative, lojëra sportive etj.

Procesi i përgatitjes së Strategjisë është i udhëhequr prej Komisioni për arsim pranë komunës së Tearcës.

- Strategjia është miratuar nga Këshilli i komunës së Tearcës në seancën e mbajtur në datën 29.06.2021.

### 1.1 Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë

Qëllimi kryesor dhe strategjik i strategjisë për INA të të rinjve në arsim është:

- ✓ promovimi i vlerave të përbashkëta kulturore nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëmësimore.
- ✓ Eliminimi ose zvoglimi i paragjykimve dhe stereotipeve për njëri tjetrin.
- ✓ Aktivitete të përbashkëta në mes nxënësve, të rinjve dhe të rriturve.

Komuna do të synojë për bashkëpunimin e plotë për INA dhe përfshirjen qytetare të të rinjve përmes:

- përpunimit të planit veprues komunal për aktivitetet e INA dhe përfshirjen qytetare të të rinjve, bazuar në elementet e planifikimeve vjetore të shkollave;

- sigurimit të mjeteve financiare, mbështetjes tjetër materiale dhe logjistike për shkollat në pjesën e aktiviteteve për INA dhe përfshirjen qytetare të të rinjve;
- formimit të komisionit komunal për planifikim, pjesëmarrjes në realizim dhe ndjekjen e realizimit të aktiviteteve për INA dhe përfshirjen qytetare të të rinjve;
- përfshirjen aktive të të punësuarve në disa sektorë dhe departamente veçanërisht në departamentin e arsimit;
- bashkëpunimit me ekipet për integrim shkollor të shkollave komunale fillore dhe të mesme, përfaqësuesit e Këshillave shkollorë, Këshillat e prindërve dhe bashkësinë lokale;
- bashkëpunimit me organizatat joqeveritare nga sfera e arsimit interkulturore, bashkëpunimit ndëretnik dhe aksionet e ndryshme në bashkësi;
- bashkëpunimit me institucionet kryesore arsimore (MASH, BZHA, ISHA dhe QATP);
- bashkëpunimit dhe këmbimit të përvojave me komunitat e tjera;
- informimit të opinionit për aktivitetet për INA përmes përdorimit të përmbajtjeve nga uebfaqja e komunës, mediat lokale dhe kombëtare elektronike;
- organizimit të fushatave, debateve dhe tryezave të rrumbullakëta për ngritjen e vetëdijes së popullatës për përfitimet e arsimit të integruar ndëretnik dhe përfshirjen qytetare të të rinjve në shoqëri;
- udhëheqjes së procesit për vendosjen e partneriteve midis shkollave për realizimin e aktiviteteve për integrimin ndëretnik;
- nxitjes dhe mbështetjes për krijimin e rrjetit në komunë dhe/apo në bashkëpunim me komunitat e tjera për realizimin e bashkëpunimit midis shkollave dhe komunave në domenin e integritit ndëretnik dhe përfshirjen qytetare të të rinjve.

## 1.2 Metodologjia

- Strategjia është e përgatitur me përfshirjen aktive të përfaqësuesve të komunës në trajnimet për INA dhe përmes mbështetjes së mentorëve dhe vizitave dhe diskutimeve të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e komunës së Tearcës në periudhë prej viti 2020 deri maj 2021.

## 1.3 Parimet e INA në nivel të komunës

- Besim dhe partneritet i ndërsjellë

Komuna e Tearcës në kontinuitet përkrahë, promovon partneritet në mes shkollave, besim reciprok, kyçje të të gjitha palëve të involvuara në proces, rritja e besimit të ndërsjell, promovim i ideve dhe risive inovatore nga të rrinjët, kyçje aktive të prindërve, të rrinjëve në vendimmarrje.

- Pjesëmarrja dhe këmbimi i mendimeve

Të gjitha shkollat e komunës, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, institucionet tjera arsimore, këshillin komunal, administrata komunale sektori civil do të këmbëjnë informata kthyesë rreth promovimit të multikulturës dhe bashkëjetesës në komunën tonë.

- Transparenca

Komuna e Tearcës, ka obligim që në kohë dhe saktë të informojë opinionin publik për aktivitete e INA-s, nëpërmjet rrjeteve sociale, WEB faqes zyrtare të komunës, fletore zyrtare të komunës, web faqet e organizatave joqeveritare që gravitojnë dhe funksionojnë në atarin e komunës së Tearcës.

- Përgjegjësia

Detyra parësore e shkollave është të përgadit individ të përgjegjshëm i cili nesër do jetë bartës i procesve shoqërore ku në epiqendër do jetë afirmimi i vlerave të përbashkëta të komuniteteve. Rritja e dinamikës dhe promovim i aktiviteteve të përbashkëta shkollore.

- Mundësi të barabarta

Një nga vlerat primare të konventës ë Kopenhagës, si dhe Unicef-it është mundësi të barabarta për të gjithë, pa dallim. Promovim i aftësive individuale dhe univerzale, nëpërmjet inkluzionit, do rritet vetëdija për fëmijët me nevoja të veçanta.

#### 1.4 Target grupe

Kjo strategji i përfshin komunat, shkollat, prindërit si dhe organizatat qytetare, bizneset lokale dhe gjithsesi qytetarët e komunës së Tearcës

#### 1.5 Korniza kohore

Korniza kohore për zbatimin e Strategjisë është 5 vjet dhe ajo do të zbatohet prej qershor 2021 deri qershor 2026 . Në planin veprues, si pjesë përbërëse e Strategjisë, në mënyrë të detajuar janë përcaktuar afatet për realizimin e aktiviteteve të planifikuara për integrimin ndëretnik në arsim.

## 2. KORNIZA KOHORE DHE MUNDËSITË PËR INTEGRIMIN NDËRETNIK NË ARSIM

### 2.1 Integrimi ndëretnik në arsim në dokumentet strategjike të RMV

Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese e dokumenteve ndërkombëtare të ardhshme të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmisë si dhe të drejtat qytetare:

- Neni 26 i Deklaratës Universale për të drejta të njeriut;
- Neni 27 i Paktit ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike;

- Nenet 28, 29, 30 të Konventës së të drejtave të fëmijës; Neni 5 i Konventës së UNESCO-s kundër diskriminimit në arsim;
- Paragrafet 34 dhe 35 të Dokumentit nga takimi i Kopenhagës nga Konferenca për dimensionin njerëzor të OSBE-së;
- Nenet 2 dhe 4 të Deklaratës së KB-së për të drejtat e personave të cilat u takojnë pakicave kombëtare apo etnike, religjioze dhe gjuhësore;
- Nenet 5, 6, 12, 13, 14 dhe 15 nga Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare;
- Karta evropiane e Këshillit të Evropës për gjuhë regjionale dhe të pakicave;
- Karta Evropiane e Këshillit të Evropës për kohezionin social.

Karakteri multietnik i vendit është definuar në Kushtetutën e RM-së, në ligjet për arsim fillor dhe të mesëm si dhe në Strategjinë kombëtare për zhvillimin e arsimit dhe Konceptin e arsimit edukativ fillor të nëntëvjeçares.

Multikulturalizmi dhe t'i kuptoni "të tjerët" është një prej katërbëdhjetë parimeve në kuadër të Konceptit për arsimin fillor nëntëvjeçar. Sipas këtij parimi nxënësit përmes përmbajtjeve mësimore, metodave dhe aktiviteteve duhet të fitojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për t'i kuptuar dhe respektuar "të tjerët" si dhe për promovimin e vlerave midis nxënësve – respektimin e dallimeve midis njerëzve, kulturën e tyre, gjuhën dhe traditën.

## 2.2 Arsimitimi i bashkësive në pajtim me Kushtetutën e RMV

- Sipas Kushtetutës secili ka të drejtë për arsim. Arsimi është në dispozicion për të gjithë me kushte të barabarta. Arsimi fillor dhe i mesëm janë të obligueshëm dhe falas. Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë në mënyrë të lirtë ta shprehin dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe karakteristikat kombëtare. Republika e Maqedonisë së Veriut e garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar. Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë për mësim në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në shkollat ku mësimi zbatohet në gjuhët e bashkësive të tjera etnike, mësohet edhe gjuha maqedonase<sup>1</sup>. Kushtetuta dhe ligjet të cilat lidhen me arsimin përmbajnë dispozita me të cilat promovohet respektimi i
  - kulturave të ndryshme, toleranca dhe jodiskriminimi

---

<sup>1</sup> Neni 44 dhe Neni 48 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 2.3 Karakteri multietnik i RMV-së në Ligjin për arsim fillor dhe Ligjin për arsim të mesëm

- Ligji për arsim fillor e ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, statusit kombëtar, social, politik apo religjioz në realizimin e së drejtës së arsimit fillor. Pjesa tjetër është pjesë e qëllimeve të arsimit fillor: 1) zhvillimin e arsimit dhe aftësive për të kuptuar, informuar dhe shprehjen e gjuhës maqedonase si dhe të gjuhëve të bashkësive; 2) arsimin për tolerancën e ndërsjellë, bashkëpunimin, respektimin e diversiteteve, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Ligji për arsim të mesëm, gjithashtu, nuk lejon diskriminime të bazuara në gjini, racë, ngjyrën e lëkurës dhe përkatësinë sociale, bindjen politike dhe fetare, pozitën pronësore dhe shoqërore. Sipas këtij ligji arsimit të mesëm është i obligueshëm për çdo qytetar, me kushte të barabarta të përcaktuara me këtë ligj.

Në kuadër të kompetencave kryesore profesionale dhe standardeve për mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesional dhe drejtorët, një prej gjashtë kompetencave i kushtohet sferës së "Inkluzionit social dhe arsimor", duke e vënë theksin në zhvillimin e kompetencave multietnike.

## 2.4 Udhëzimet tematike në Strategjinë e RMV-së për arsim të integruar

Një pjesë e këtij teksti duhet të përfshihet:

- Masat e Strategjisë janë të ndara në 2 drejtime tematike . Udhëzimet e dhëna në fushat tematike i prekin çështjet e : mbisundimit të demokracisë në shkolla në një mjedis të decentralizuar, aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore, arritjet gjuhësore, përmbajtjet dhe tekstet shkollore mësimore, si dhe trajnimin për mësimdhënësit për konceptet dhe parimet udhëheqëse për tejkalimin e ndarjes në linja etnike dhe gjuhësore në shkolla.

Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës është formuar një grup me përgjegjësi për ndjekjen e punës së aktiviteteve konkrete në shkolla për integrimin ndëretnik. Është e rëndësishme të përmendet se një prej qëllimeve të këtij grupi të punës është të shmanget përputhja e aktiviteteve për INA në terren.

## 2.5 Palët e involvuara në procesin e arsimit

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka mision për ta zhvilluar arsimin dhe sistemin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për ta zhvilluar shkencën, arritjet shkencore dhe inovacionet përmes zbatimit të parimeve të cilësisë, punës ekonomike, përgjegjësisë shoqërore dhe lidhjes së punës së tregut. Me zbatimin e këtyre parimeve do të mundësohet edhe pjesëmarrje e barabartë e Republikës së Maqedonisë së Veriut me proceset integruese arsimore, ekonomike dhe politike. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka vizion t'i promovojë vlerat dhe themelet e arsimit cilësor si çelës për përmirësimin e cilësisë së jetesës në mbarë shoqërinë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndan grante të vogla për të gjitha shkollat në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilat do të aplikojnë me aktivitete për integrimin ndëretnik në arsim.

- Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA)

BZHA është organ i administratës në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm arsimor, përfshirë edhe planet dhe programet mësimore. Të gjitha vendimet sillen në nivel qendror edhe pse BZHA i ka zyrat e veta edhe në qytetet më të mëdha. Nga viti 2012 këshilltarët e BZHA-së janë pjesë e një numri të madh vendimesh lidhur me integrimin ndëretnik në arsim.

- Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA)



ISHA është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe bën mbikëqyrjen mbi plotësimin e standardeve arsimore, sigurimin e cilësisë së arsimit, efektivitetin përmes vlerësimit të punës së institucioneve edukativo-arsimore, si dhe zbatimin e ligjeve, rregullat e tjera dhe aktet e përgjithshme të arsimit dhe edukimit. Gjatë përcaktimit të vlerësimit të cilësisë së procesit edukativo-arsimor, gjatë vlerësimit integral, nisët prej Indikatorëve për cilësinë e punës në shkollat të cilat janë rregulluar dhe sjellë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Indikatorët gjithashtu përdoren për t'u bërë shqyrtim në punën e shkollave nga aspekti i integritimit ndëretnik në arsim.

- *Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT)*

QAPT është institucion publik në të cilin duhet të harmonizohen dhe të integrohen interesat publike dhe interesat e partnerëve socialë në arsimin profesional dhe trajnimin në RMV dhe është qendër e cila e koordinon bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në sferën e arsimit dhe trajnimit profesional. Qendra bën punë profesionale nga sfera e ndjekjes, vlerësimit, studimit, zhvillimit, hulumtimit dhe zhvillimit të arsimit profesional dhe trajnimit, si edhe punë të tjera në pajtim me Ligjin, aktin e themelimit dhe statutit.

- *Qendra Shtetërore e Provimeve (QSHP)*

Kompetencat e QSHP-së janë të përgatitet programi nacional për vlerësimin ekstern në arsimin fillor dhe të mesëm në pajtim me standardet evropiane; të grumbullohet, përpunohet dhe bëhet analizë e rezultateve të testimit për të kontrolluar njohuritë e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm; të merret pjesë në përgatitjen dhe konceptimin e maturës dhe provimeve përfundimtare në arsimin e mesëm; të përpilohen tekste për provimet eksterne në maturën shtetërore; dhe të bëjë trajnimin e kandidatëve për drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme dhe ta zbatojë provimin.

- *Këshillat shkollorë<sup>2</sup>*

Këshilli shkollor është trup vendimarrës për udhëheqjen e shkollës. Përbërja, kompetencat dhe detyrat e këshillit shkollor përcaktohen me Ligjin për arsim fillor dhe statutin e shkollës. Roli i këshillit shkollor në shkollë është të sjellë statut për shkollën fillore; propozon program vjetor për punë dhe raport për punë në shkollën fillore për këshillin komunal; sjellë program për zhvillimin e shkollës; sjellë program për vendosjen e standardeve më të larta dhe programe të tjera; propozon plan financiar dhe llogari përfundimtare dhe bën edhe punë të tjera të përcaktuara me statutin e shkollës fillore.

- *Udhëheqësia e shkollës (drejtori dhe shërbimi profesional)*

Udhëheqësia e shkollës (drejtori dhe shërbimi profesional) janë trajnuar për aplikimin e INA në aktivitetet e shkollës përmes përgatitjes së planeve vjetore të punës të cilat përfshijnë pjesë të veçantë për aktivitete të përbashkëta shkollorë dhe partneritet me shkollat e tjera. Udhëheqësisë së shkollës i nevojitet zhvillim profesional i vazhdueshëm për drejtimin më të madh dhe të suksesshëm me resurset njerëzore dhe financiare për përfundimin e kapaciteteve të tyre për t'u përballur më mire me të gjitha obligimet në mënyrë profesionale.

- *Mësimdhënësit*

Mësimdhënësit e të gjitha shkollave fillore dhe të mesme janë të trajnuar se si të planifikojnë dhe të realizojnë aktivitete për INA në kuadër të mësimin të rregullt dhe në aktivitetet jashtëmësimore me fokus në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve. Mësimdhënësit edhe më tej u nevojitet mbështetje plotësuese në aplikimin e aktivitetëve të përbashkëta të nxënësve midis nxënësve.

- *Prindërit – këshilli i prindërve*

---

<sup>2</sup> Këshilli shkollor përbëhet nga: personeli i shkollës (menaxhmenti, shërbimi profesional dhe mësimdhënësit), përfaqësues të komunave dhe prindërve.

Edhe pse prindërit mund të marrin pjesë në aktivitetet mësimore të përditshme dhe të jenë partnerë të mësimdhënësit dhe shkollës në përgjithësi, përfshirja e tyre është e vogël. Në pajtim me Ligjin për arsim fillor, prindërit i kanë tre përfaqësues të emëruar nga këshilli i prindërve në këshillin shkollor. Në këtë mënyrë prindërit mund të marrin pjesë në procesin e sjelljes së vendimeve në shkollë për propozimin e programit vjetor të punës së shkollës dhe raportin vjetor. Përpunimin e planit financiar, sjelljen e statutit të shkollës etj. Kjo do të thotë se përfshirja e prindërve në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore mund të kontribuojë në zhvillimin e kohezionit ndëretnik të nxënësve të bashkësive/gjuhëve të ndryshme dhe në përfshirjen e tyre në nismat qytetare dhe aksionet për përmirësimin e cilësisë së jetesës në shkollë, bashkësinë lokale dhe shoqërore.

### 3. ARSIMI NË NIVEL TË KOMUNËS

#### 3.1 Decentralizimi në arsimin e RMV-së

Çfarë është arritur në nivel të komunës/bashkësisë lokale me procesin e decentralizimit në arsim?

Cilat janë përgjegjësitë në sistemin arsimor të pushtetit qendror ndërsa cilat janë përgjegjësitë e komunës?

Me decentralizimin në arsim do të bëhet redistribuimi i përgjegjësisë për problemet kryesore të arsimit (përmirësimi i kualitetit të arsimit, përparimi profesional i mësimdhënësve, finansimi) në të tre nivelet e sitemit arsimor – qendror, lokal dhe shkollor. Përgjegjësitë do të zmadhohen në rrafshin lokal dhe shkollor në llogari të koncentrimit të përgjegjësisë në nivel qendror.

Komunat duhet të kenë influencën e tyre në përfundimin e pjesëmarrjes demokratike në promovimin e bashkëpunimit mes institucioneve arsimore dhe komunitetit lokal.

- Komunat duhet të ndikojnë në përfundimin e pjesëmarrjes demokratike në promovimin e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe bashkësisë lokale.

#### 3.2 Të dhëna për shkollat fillore dhe të mesme në komunë

Tabela 1. Lista e shkollave fillore dhe të mesme komunale

nr.r.	Emri i shkollës fillore	vendbanimi	Kuatridhësimor			Nxënës		
			Shq	Maq	Tur	Shq	Maq	tur
1	Shfk "Faik Konica"	Dobrosht	36	4		364	17	
2	Shfk "Ismail Qemali"	Nerasht	30			276		
3	Shfk "Asdreni"	Glllogjë	35	1		249	5	
4	Shfk "Kiril Pejçinoviç"	Tearcë	29	20	7	191	100	21
5	Shfk "Eqrem Çabej"	Sllatinë	45	3		504	16	
6	Gjithësejt		175	28	7	1584	141	21

#### 3.3 Këshilli i komunës

- Këshilli i komunës është themelues i shkollave dhe i sjellë programet vjetore dhe raportet vjetore të shkollave. Anëtarët e këshillave në komuna, përmes komisioneve përkatëse për

arsim sipas rregullit kanë monitorim të vazhdueshëm, duke e përfshirë edhe periudhën kur sillen programet vjetore dhe raportet e shkollave.

Në kuadër të kompetencave të tyre, këshilli i komunës:

- i emëron dhe i shkarkon përfaqësuesit e kshillave shkollore, e shqyrton dhe e miraton raportin vjetor për punën e shkollave,
- e shqyrton dhe e miraton programin vjetor për punën e shkollës,
- e shqyrton dhe e sjellë planin vjetor financiar të shkollës,
- e shqyrton dhe e miraton llogarinë përfundimtare të shkollës,
- mundet ISHA t'i dorëzojë kërkesë për vlerësim të jashtëzakonshëm integral dhe kontrollin eksterne dhe vlerësimin e progresit dhe arritjeve të nxënësve.

### 3.4 Përgatitja e mësimdhënësve

Në çdo shkollë është formuar ekip për integrim shkollor (EISH), anëtarët e së cilit përmes trajnimeve të ndryshme kanë fituar njohuri dhe aftësi për zbatimin e aktiviteteve për INA me nxënësit. Njohuritë dhe aftësitë e fituara ekipet për integrim shkollor i diseminuan në shkolla dhe me atë të gjithë mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të trajnuar të planifikojnë dhe të zbatojnë aktivitete për integrimin ndëretnik në mësimin e rregullt dhe në aktivitetet jashtëmësimore.

## 4. AKTIVITETE NË SHKOLLA PËR ZHVILLIMIN E INRA

### 4.1 Fushat e planifikimit

#### 4.1.1 Aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore

- Komuna do të mbështesë aktivitete të përbashkëta mësimore (orë të përbashkëta) me nxënës nga gjuhë të ndryshme mësimore, sipas vëllimit dhe shumëllojshmërisë që do të dalin nga programet vjetore të miratuara të shkollave fillore, dhe që kanë të bëjnë me INA për sa i përket pjesës të mbajtjes së mësimin të përbashkët. Orët e përbashkëta në lëndë të caktuara me nxënës nga gjuhë të ndryshme mësimore/bashkësi mund të zhvillohen ekskluzivisht me trajnime paraprake nga mentorë/ekspertë të mësimdhënësve për realizimin e këtij lloji të veçantë të mësimdhënies.
- Komuna do të mbështesë aktivitete jashtëmësimore sipas vëllimit dhe sipas vëllimit dhe shumëllojshmërisë që do të dalin nga programet vjetore të miratuara të shkollave fillore, dhe që kanë të bëjnë me INA në pjesën e seksioneve, ekskursioneve, ndeshjeve apo garave, shfaqjeve, punëtorive multikulturore, aktiviteteve artistike të bashkësive shkollore, nismave qytetare dhe aksioneve dhe të tjera.

Afirmimin e nxënësve dhe shkollave komuna do ta realizojë përmes ueb faqes së saj, në seancat e komisionit për arsim, kulturë dhe sport, në seancat e këshillit komunal, përmes drejtimit të kryetarit të komunës për raportet e sjella vjetore të shkollave fillore dhe të mesme, në TV kanalet lokale.

#### 4.2 Përmirësimi i kompetencave interkulturore tek nxënësit

Komuna zhvillon sistem të organizimit të veprimtarive të përbashkëta për INA, përmes takimeve të organizuara ndër shkollore të shkollave shumëgjuhëshe dhe njëgjuhëshe, ku përvojat ndahen, fitohen njohje të reja, planifikohen veprimtari të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore. Komuna do të kujdeset për përmirësimin e kompetencave ndërkulturore të nxënësve, veçanërisht duke i përfshirë mësimdhënësit, prindërit dhe duke rritur vazhdimisht numrin e nxënësve të përbërjes etnike të përzier në aktivitete jashtëmësimore.

#### 4.3 Këmbimi i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit

Komuna do të organizojë takime të përbashkëta të aktiveve profesionale të shkollave fillore me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe shkëmbimit të informacioneve në planifikimin e aktiviteteve mësimore të përbashkëta dhe aktiviteteve jashtëmësimore - aktiviteteve të integruara. Thëks i veçantë i kushtohet organizimit të orëve të përbashkëta, seksioneve të përbashkëta, ekskursioneve dhe shfaqjeve. Komuna do të mbështesë takime konsultative dhe organizative me mentorë/ekspertë për planifikimin e mësimin, aktiviteteve për INA etj.

#### 4.4 Përcaktimi i nevojave arsimore të nxënësve

Komuna do të mbështesë aktivitete për sigurimin e mbështetjes së veçantë të nxënësve të cilët mësojnë gjuhë të ndryshme nga gjuha amtare përmes vizitave të organizuara të kurseve të gjuhës, përdorimin e teknikave interaktive – kurseve kompjuterike, ekspozitave artistike, ngjarjeve të ndryshme të përbashkëta dhe shoqërimit midis tyre gjatë mësimin dhe jashtë mësimin të rregullt.

### 5. KLIMA SHKOLLORE DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLË ( të drejtat e fëmijëve, trajtim i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve, pranimi dhe promovimi i multikulturalizmit)

Komuna do të mbështesë aktivitete – punëtori, takime, ligjërata dhe bashkëpunim ndëretnik për njoftimin e prindërve dhe mësimdhënësve për respektimin e të drejtave të fëmijëve në pajtim me Konventën për të drejtat e fëmijëve. Komuna do t'i ndjekë mekanizmat me të cilat do të sigurohet promovimi i barazisë dhe përfaqësimit ndaj fëmijëve pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, origjinës sociale dhe aftësive.

Komuna do të kujdeset të planifikohen dhe realizohen aktivitete me të cilat nxënësit do të stimulohen për të dëgjuarit aktiv, shprehjen e mendimit dhe pranimin e mendimit të të tjerëve në grup, pjesëmarrjes demokratike në shkolla dhe në nivel të bashkësisë etj.

Komuna do të përkujdeset shkollat të udhëheqin politikë të vlerësimit pozitiv dhe promovimit të diversitetit gjinor, etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor në shkollë dhe në bashkësi, pranimin e tyre të ndërsjellë dhe mbështetjen. Komuna do të mbështesë aktivitete në të cilat nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike/gjuhësore mësojnë ta respektojnë kulturën dhe traditën e tyre dhe kulturën dhe traditën e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

### 6. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME SHKOLLAT DHE BASHKËPUNIMI NDËRETNIK

Me qëllim që të stimulohen, mbështeten dhe zhvillohen aktivitetet e INA dhe përfshirja qytetare e të rinjve me nisma dhe në aksione në bashkësi, si dhe që të ruhet dhe zhvillohet bashkëpunimi i komunës me shkollat për përforcimin e INA në nivel të komunës, aktivitetet të cilat i zbaton komuna janë si në vijim:

- pjesëmarrja në trajnime, punëtori dhe takime me tema dhe aktivitete për INA;

- përpunimi i planit veprues të komunës për INA i cili shoqërohet me miratim nga këshilli i komunës, drejtimi, ndjekja, koordinimi dhe mbështetja e shkollave për zbatimin e aktiviteteve për INA;
- sigurimi i resurseve të përshtatshme për shkollat për zbatimin e aktiviteteve për INA;
- organizimi i ngjarjeve për promovimin e INA në nivel të komunës dhe përfshirja e mediave për informimin e opinionit;
- mbështetje dhe pjesëmarrje në organizimin e fushatave, debateve dhe tryezave të rrumbullakëta për ngritjen e vetëdijes së popullatës dhe përfitimet e INA;
- publikimi i tregimeve të suksesshme për INA në ueb faqen e komunës;
- udhëheqja e procesit për partneritet midis shkollave për INA;
- mbështetja dhe stimulimi në krijimin e rrjetit të shkollave në komunat dhe midis komunave të ndryshme për realizimin e bashëpunimit midis shkollave dhe midis komunave për INA;
- bashkëpunimi me institucionet arsimore (MASH, BZHA, ISHA dhe QATP), organizatat joqeveritare dhe komunat e tjera.

.....

Në komunë emërohet personi përgjegjës apo ekipi/trupi koordinues i INA për përfshirjen qytetare të të rinjve që mban komunikim të rregullt dhe bashkëpunim me ekipet për integrim shkollor (EISH). Personi përgjegjës apo ekipi/trupi koordinues për INA duhet të kërkojë prej ekipit për integrim shkollor në çdo shkollë të:

- dërgojë plan global veprimi dhe plane vepruese të detajuara për aktivitetet për INA;
- njoftojë rregullisht për datat për aktivitetet e INA në shkollë (nga – deri në ditë para aktivitetit);
- informojë rregullisht për arritjet dhe pengesat/problemimet/sfidat eventuale në realizimin e aktiviteteve për INA në shkollë.

## 7. MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E INA NË FILLIM TË VITIT SHKOLLOR

Me qëllim që të mbështeten shkollat në përmirësimin e mëtejshëm të aktiviteteve për INA në nivel të komunës si dhe të shqyrtohet niveli i arritjes së INA dhe nevoja e organizimit të mbështetjes dhe ndihmës së mëtejshme nga komuna për shkollat, personi përgjegjës apo ekipi/trupi koordinues për INA organizoi takime me koordinatorët e ekipeve për integrimin shkollor gjatë muajit gusht për: njoftimet për arritjet në INA dhe përfshirjen qytetare të të rinjve në shkollat gjatë vitit të kaluar shkollor; shqyrtimi i mundësive për zhvillimin e aktiviteteve për INA dhe përfshirjen qytetare të të rinjve në shkollat dhe komunë; planifikimi i aktiviteteve për INA dhe përfshirjen qytetare të të rinjve gjatë vitit të ardhshëm shkollor dhe futjen në programet vjetore për punën e shkollave për vitin e ardhshëm shkollor. Për këtë qëllim komuna do të përgatisë plan vjetor aksional. (skema 1).

## 8. DUKSHMËRIA E ARRITJEVE TË KOMUNËS NË ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR INA DHE ANGAZHIMIN QYTETAR TË TË RINJVE

Në këtë pjesë duhet të përshkruhen të gjitha veglat për informimin e publikut që komuna i përdor për të informuar publikun në RMV. Edhe atë, duke filluar nga përgatitja e Strategjisë, përmes të gjitha aktiviteteve dhe praktikave të mira në shkollat dhe kontributit të komunës në zbatimin e aktiviteteve për INA dhe veprimet qytetare dhe iniciativat rinore, e deri në shënimin/promovimin e arritjeve që kanë një pjesë të madhe për kohezioni ndëretnik më të fuqishëm dhe cilësi të ngritur në nivelin e bashkësisë lokale dhe më gjerë në shoqërinë tonë.

**PLANI AKCIONAL KOMUNAL I STRATEGJISË KOMUNALE PËR INTEGRIM NDËRETNIK NË ARSIM  
DHE PARTICIPIM DEMOKRATIK TË KOMUNËS SË TEARCËS**

<b>Rezultati i pritur 1:</b>						
Ekipet shkollore dhe komunale të mobilizuara dhe të përgatitura për avansimin e aktiviteteve për integrim ndëretnik në arsim (INA)						
	Përshkrimi i aktiviteteve	Përgjegjës	Afati kohor	Indikatorët	Resurset	Përkrahja dhe monitorimi
1.1.	Mbledhje të rregullta të Komisionit për INA pranë komunës për planifikimin, monitorimin dhe realizimin e aktiviteteve INA në shkollat komunale dhe më gjërë	Komisioni komunal për INA	Takime mujore	Është vendosur strukturë për përkrahjen dhe avansimin e aktiviteteve INA	Njerëzore	Spektori për arsim...
1.2.	Takime me përfaqësuesit e ekipeve shkollore për INA, njohimi i tyre për aktivitetet e planifikuara vjetore komunale, informimi i tyre me mundësitë për grande. Mundësi për ndarjen e përvojave të mira mes shkollave..	Komisioni komunal për INA	Fillim të vitit akademik-shtator	Takim i realizuar midis ekipeve shkollore për INA dhe Komisionit komunal për INA	Njerëzore	Spektori për arsim... dhe Ekipet shkollore për INA
1.3.	Përkrahje në krijimin e rrjetit shkollor komunal për realizimin e partneritetit për realizimin e aktiviteteve INA	Komisioni për INA, Spektori për arsim dhe kulturë... Dhe ekipet shkollore për INA	2021-2026 Në kontinuitet	Rrjet i krijuar mes shkollave në nivel komunal dhe më gjërë, për realizimin e aktiviteteve INA	Njerëzore	Komisioni komunal për INA, Ekipi shkollor për INA
<b>Rezultati i pritur 2</b>						
Integrim ndëretnik i avansuar përmes aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore						
	Përshkrimi i aktiviteteve	Përgjegjës	Afati kohor	Indikatorët	Resurset	Përkrahja dhe monitorimi
2.1.	Planifikim vjetor i aktiviteteve INA (plan akcional i përpiluar, aktivitete INA të planifikuara në Programën për punë të shkollës)	Shkollat fillore komunës së Tearcës	2021-2026	Plan vjetor i përpiluar për aktivitetet INA në kuadër të çdo shkolle	Njerëzore	Ekipi shkollor për INA dhe Komisioni komunal për INA
2.2.	Realizimi i anketës për matjen e të arriturave shkollore për aktivitetet INA - Përpilimi i pyetësorëve - Distribuimi nëpër shkolla (e-mail) Mbledhja dhe përpunimi i rezultateve	Komisioni komunal për INA	Në maj të çdo viti	Analiza e rezultateve për çdo vit shkollor dhe krahasimi me vitet e kaluara	Njerëzore	Spektori për arsim... dhe ekipet shkollore për INA

2.3.	Motivimi i shkollave për realizimin e orëve të përbashkëta nga sporti, arti figurativ dhe gjuhët e huaja në shkollat fillore	Shkollat fillore	2021-2026 Në kontinuitet	Në çdo shkollë fillore dy/tregjuhësore janë realizuar orë të përbashkëta në së paku dy lëndë me së paku një klasë.	Njerëzore, materiale dhe finansiare	Komisioni komunal për INA dhe Ekipet shkollore për INA
2.4.	Realizimi i përbashkët i manifestimeve për gjysëmaturë	Shkollat fillore	2021-2026 qershor	Në shkollat dy/tregjuhësore janë realizuar manifestime të përbashkëta për maturë dhe gjysëmaturë	Njerëzore dhe finansiare	Komisioni komunal për INA dhe Ekipet shkollore për INA

### Rezultati i pritur 3:

Ngritja e vetëdijes së nxënësve, të rinjëve dhe qytetarëve për participim demokratik në shoqëri, përmes realizimit të proekteve me shkollat dhe organizimit të eventeve me interes të përbashkët për gjithë qytetarët

	Përshkrimi i aktiviteteve	Përgjegjës	Afati kohor	Indikatorët	Resurset	Përkrahja dhe monitorimi
3.1.	Panairi i gatimeve tradicionale.	Sektori për arsim.... Komisioni për aktivitete INA Partner social – Kuzhina popullore, prindër	2021 – 2026 tetor	Realizimi i panairit me shtande dhe pjesëmarrës	Njerëzore, materiale dhe finansiare nga komuna	Kryetari i komunës dhe Sektori për arsim
3.2.	Aksion Ekologjik Nxënësit përgatisin materiale recikluese –Grumbullimi i kanaqeve,plastikës	Sektori për arsim.... Komisioni për aktivitete INA Prindër, Ekipet shkollore	2021-2026 Dita e ekologjisë	Realizimi i manifestimit për Ditën e Ekologjisë.	Njerëzore, materiale dhe finansiare nga komuna	Kryetari i komunës dhe Sektori për arsim
3.3.	Aktivitetet për ditën botërore të librit.Biblioteka në rrota,bashkëpunim me OJQ “Loja” Tetovë Pjesëmarrës autor librash.	Sektori për arsim.... Komisioni për aktivitete INA Prindër, Ekipet shkollore	2021-2026 Dita botërore e librit	Realizimi i aktiviteteve për ditën botërore të librit	Njerëzore, materiale dhe finansiare nga komuna	Kryetari i komunës dhe Sektori për arsim
3.4.	Ngjyrosja dhe adaptimi/mural i objektit shkollor.	Arsimtarët e artit figurativ Komisioni për INA, Ekipet shkollore për IN	2021-2026 Katër herë mbrenda një viti	Monument i ngjyrosur me dukje karakteristike për stinën në të cilën gjendemi	Njerëzore, materiale dhe finansiare nga komuna	Sektori për arsim

Rezultati e pritur 4						
Aktivitete e realizuara INA promovohen, komuna dhe shkollat për afirmimin e aktiviteteve INA shfrytëzojnë mediumet e ndryshme (p.sh. revistë shkollore, radio shkollore, internet faqe, rrjetet sociale, këndin për nxënës etj.)						
2.1.	Përpilimi i dokumentit nga nxënësit dhe prindërit për rezultatet nga realizimi i aktiviteteve INA	Ekipi shkollor për INA, Komisioni për INA, bashkësia e shkollës	2021-2026 Shtator-tetor	Nxënësit të motivuar ndajnë përvojat e tyre për INA aktivitete e realizuara	Njerëzore, materiale	Komisioni komunal
2.2.	Hapja e INA portal në kuadër të shkollave dhe bartja e informacioneve nga portalet shkollore në atë komunale	Ekipi shkollor për INA, Komisioni për INA	2021-2026 Në kontinuitet	Ekipe shkollore dhe Komisioni komunal janë aktivisht të kyçur në promovimin e aktiviteteve	Njerëzore, materiale	Spektori për arsim
2.3.	Përpilimi i propozim proekteve për finansimin e aktiviteteve shkollore për INA	Komisioni për INA dhe Komisioni për arsim pranë Këshillit komunal	2021-2026 Në kontinuitet	Komuna siguron mjet finansiare të pakthyeshme një herë në vit për realizimin e aktiviteteve INA në komuna	Njerëzore dhe finansiare	Kryetari i komunës, Këshilli komunal- Komisioni për arsim